



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, më 25 prill 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 14-22 prill 2023 (**Vendimi nr. 26, datë 25.04.2023**)
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “MAXCOM” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor Maxcom” (**Vendimi nr. 27, datë 25.04.2023**).
3. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Tele.co.Albania” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor Tele.co.Albania”, për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit, duke hequr dorë nga “Njësia administrative Kashar” (**Vendimi nr. 28, datë 25.04.2023**).
4. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Net 3 Digital” sh.p.k., autorizuar për ofrimin dhe përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “Net 3 Digital TV” (**Vendimi nr. 29, datë 25.04.2023**).
5. Caktimin e dënimit me gjobë ndaj subjektit audioviziv “Report TV”, për shkelje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, gjatë transmetimit të emisionit “Pa Gjurmë” në datën 6 prill 2023. (**Vendimi nr. 30, datë 25.04.2023**).
6. Pranimin pjesërisht të ankimit administrativ të subjektit person fizik Guri Meko, autorizuar për përsëritjen e programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Aral”, kundër vendimit për dënimin me gjobë nr. 1 datë 20.02.2023 dhe ndryshimin e masës së dënimit me gjobë (**Vendimi nr. 31, datë 25.04.2023**).
7. Pranimin e ankimit administrativ të paraqitur nga shoqëria “IClick.AL” sh.p.k., kundër

vendimit për dënimin me gjobë nr. 2 datë 22.02.2023, vendosur ndaj subjektit “TV Kabllor 1Click.AL” (Vendimi nr. 32, datë 25.04.2023).

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 25 prill 2023

